

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                        |
|---------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Komediani turk dënohet me 19 muaj burg për fyerje ndaj Erdoganit, përdori termin 'diktator' në një shfaqje humoristike |
| ADRESA  | https://dosja.al/bota/komediani-turk-denohet-me-19-muaj-burg-per-fyerje-ndaj-erdoganit-p-erdori-te-i516551             |
| BURIMI  | dosja.al                                                                                                               |
| GJENDJA | online                                                                                                                 |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 28 shtator 2026, 15:14:55 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 15:03:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | bfd8151dc451588aa3b51bdab1fffca633581896bbf18d63f7057402922188a8 |
| TEKSTI     | 2d1b227885c61f11417d9e2adb40132a40d7a8f3402d804fbef2002ad4f9472a |
| PAMJA      | 50ac9955cb5b2411904487be0b3c08b956a574c6d1ba402e7e3201e7fa8a2f46 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | b9ce6096f6d4e89203f9789e00fc0e16c46413a51bacb8adcd0f4c517f4a53b                                 |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8                                 |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/b9ce6096f6d4e89203f9789e00fc0e16c46413a51bacb8adcd0f4c517f4a53b

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





LIVE UPDATES

2 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë punën për ligjin e pagave

5 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapituajt duhen mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në baltë, do jetë dështim

6 ORE ME PARE

Përfundon mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në fokus hetimi ndaj ish-drejtoreshës së SHISH dhe siguria e informacionit të klasifikuar

22 ORE ME PARE

120 ditë protestë/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, me thirrje e pankarta në duar: Rama jep dorëheqjen

Bota

# Komediani turk dënohet me 19 muaj burg për fyerje ndaj Erdoganit, përdori termin 'diktator' në një shfaqje humoristike

32-vjeçari kishte qëndruar tre muaj në paraburgim dhe pas vendimit është liruar në pritje të apelit.



28 Shtator 2026, 17:03  
Nga G.M



Deniz Goktas

**TURQI-** Një gjykatë në Stamboll ka dënuar me 19 muaj burg komedianin turk Deniz Goktas, pasi u shpall fajtor për “fyerje të presidentit” dhe “fyerje të vlerave fetare”. 32-vjeçari kishte qëndruar tre muaj në paraburgim dhe pas vendimit është liruar në pritje të apelit.

Sipas raportimeve nga [mediat](#) e huaja, në proces, Goktas kundërshtoi akuzat dhe deklaroi se përdorimi i termit “diktator” në një shfaqje humoristike nuk përbën vepër penale. Ai argumentoi se bëhej fjalë për një përcaktim politik dhe se humori duhet të jetë i lirë nga censura dhe ndalimet.

Komediani u shpreh se një shfaqje politike ku nuk përmendet presidenti Recep Tayyip Erdogan nuk do të ishte në përputhje me realitetin politik të vendit. Goktas u shpall i pafajshëm për akuzën e lavdërimit të një krimi. Gjatë seancës, ai ruajti një qëndrim të qetë dhe herë pas here shkaktoi të qeshura në sallën e gjyqit me deklaratat e tij.

Pas vendimit, komediani tha se tre muajt e kaluar në paraburgim i ishin marrë nga jeta. Ai shtoi me ironi se, pasi kishte lënë duhanin, do të përpiqej t'i shtonte këta tre muaj në fund të jetës së tij. Deniz Goktas e nisi karrierën në skenën e stand-up-it në Stamboll në vitin 2019 dhe më pas ka performuar edhe në vende të ndryshme të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara. /Dosja.al

deniz goktas

turqi

recep tayyip erdogan

## editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

## Në vëmendje

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 16:51

Reforma territoriale/ Këshilli Bashkiak i Belshit voton kundër bashkimit me Elbasanin

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 13:36

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

FOTOLAJM/ Kush janë dy të rinjtë që tentuan të mashtronin Armand Dukën dhe lidhja me Florian Gjergjin

më të klikuarat

Labirinti i errët i Edi Ramës

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

WSJ zbardh prapaskenat: Ja si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 mld \$ në Shqipëri

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Bota

28 Shtator 2026, 16:17

“Mund të rrëzojmë çdo qeveri që duam”/ Deklarata e ambasadores amerikane shkakton polemika në Athinë, opozita kërkon shpjegime

Ministri grek i Energjisë, Stavros Papastavrou dhe ambasadorja e SHBA-së në Greqi, Kimberly Guilfoyle GREQI- Partitë opozitare t&e...

Ukraina raporton bombardime vdekjeprurëse ruse në Kiev, Harkiv dhe Dnjepër

Bota

28 Shtator 2026, 16:12

Përfshihet nga flakët Akademia e Shkencave në Kiev pas sulmeve ruse, raportohet një viktimë dhe disa të plagosur (VIDEO)

Bota

28 Shtator 2026, 15:51

BE miraton pesë programe të mbrojtëse me një buxhet prej 325 mln eurosh, mbrojtja ajrore në qendër të vëmendjes

Bota

28 Shtator 2026, 15:43

Brukseli ia kujton Serbisë nevojën për zbatimin e sanksioneve të BE-së ndaj Rusisë pas bisedës Vuçiç-Putin

Bota

28 Shtator 2026, 15:10

insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by  tomorrow.

Beta

28 Shtator 2026, 15:00

## SHBA dhe Kina ulin tarifat për 60 miliardë dollarë mallra, një hap drejt zbutjes së tensioneve tregtare mes dy ekonomive botërore

Xi Jinping dhe Donald Trump SHBA- Shtetet e Bashkuara dhe Kina kanë arritur marrëveshje për uljen reciproke të tarifave për mallra...

**VIDEO/ Spektakël mbresëlënës nga shpërthimi i vullkanit Kilauea, lava ndriçon qiellin e natës**

Beta

28 Shtator 2026, 14:16

**Pesë britanikë arrestohen pranë bazës ajrore RAF Fairford, dyshohen për përgatitje të një akti terrorist**

Beta

28 Shtator 2026, 14:04

**Dyshohet se i mori telefonin një personi dhe e hodhi lumin Danub/ Parlamenti hungarez i heq imunitetin kryeministrit Péter Magyar**

Beta

28 Shtator 2026, 13:56

**Simbol i diplomacisë/ Ping Ping dhe Fu Shuang, kush janë pandat e reja që mbërritën në Atlanta?**

Beta

28 Shtator 2026, 13:43

MË SHUMË

